



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve  
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije  
National Qualification Authority

# ZHVILLIMI I KUALIFIKIMEVE MODULARE



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar  
nga Zyra ndërlidhëse e Komisionit Evropian

PRISHTINË, 2011



**EU KOSVET V**

Zhvillimi i Sigurimit të Cilësisë, Akreditimit dhe Zhvillimi i AKK & KKK në Kosovë

**Nr. i Projektit: 2009/216-809**

Ky publikim është hartuar me përkrahjen e Bashkësisë Evropiane.  
Përmajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e kontraktorit PEM GmbH dhe në asnjë mënyrë  
nuk mund t'i pasqyrojë pikëpamjet e Bashkësisë Evropiane.



# PËRMBAJTJA

Parathënie	6
Çka është kualifikimi?	7
Veçoritë e kualifikimeve në Kosovë	9
Të shprehura si rezultate mësimore	9
Bazuar në modulet mësimore	9
Artikulimi dhe progresi	10
Vlerësimi i bazuar në dëshmi	12
Kualifikimet dhe modulet mësimore	12
Kërkesat hyrëse	14
Arsyeshmëria për kualifikimin	14
Lidhjet me punësimin	16
Bashkëngjitja e kredive për kualifikime	17
Qëllimi i sistemit të kredive në Kosovë	17
Bashkëngjitja e kredive në module	18
Bashkëngjitja e kredive në tërë kualifikimin	21
Shtojca 1	23

## PARATHËNIE

Kjo pako e veglave është zhvilluar për të sqaruar konceptin e kualifikimeve profesionale modulare dhe sekuencat kryesore të zhvillimit, validimit dhe implementimit të kualifikimeve kombëtare.

Njerëzit nga institucione të ndryshme dhe organizata janë të përfshira në proceset që kanë të bëjnë me kualifikimet. Roli dhe përgjegjësitë e tyre në këtë proces janë gjithashtu të ndryshme: disa hartojnë dhe propozojnë kualifikimet, disa validojnë dhe aprovojnë kualifikimet, disa janë të zënë me implementimin e kualifikimeve përmes proceseve të mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit, disa janë të angazhuar në procesin e certifikimit të arriturave të nxënësve.

Implementimi i përshtatshëm dhe i qëndrueshëm i kualifikimeve kombëtare profesionale varet nga të kuptuarit e përbashkët të koncepteve dhe kërkesave ligjore dhe administrative ndërmjet shfrytëzuesve të ndryshëm. Prandaj, kjo pako e veglave do të jetë e përshtatshme për përdorim si për stafin e MASHT ashtu edhe të AKK, por gjithashtu edhe për menaxhmentin dhe stafin e shkollave profesionale dhe institucioneve të arsimit dhe aftësisimit profesional, e gjithashtu edhe për palët me interes në këtë fushë.

## ÇKA ËSHTE KUALIFIKIMI?

Pothuajse në të gjithë fjalorët, termi kualifikim ka të bëjë me idenë e certifikimit dhe njohjes.

Sipas përkufizimit të OECD<sup>1</sup> kualifikimi është titull i zyrtarizimit të ushtrimit të ndonjë zanati.


Në arsim, kualifikimi ka të bëjë me njohjen e përfundimit të suksesshëm të programit mësimor që e përgatitë njeriun për punësim dhe apo shkollim dhe trajnim të mëtutjeshëm.

Zakonisht kualifikimet profesionale gjenerohen nga kërkesat e tregut të punës. Njohuritë dhe shkathhtësitë

e nevojshme për individin të kryej ndonjë funksion apo aktivitet të punë (jo domosdoshmërisht të lidhura me vendin e punës) qojnë në zhvillimin e kualifikimit.

Diagrami vijues e tregon integrimin e kualifikimit në ciklin e zhvillimit të AAP. Ky diagram i thekson fazat kryesore në krijimin, hartimin dhe implementimin e kualifikimeve, nga kompetencat profesionale deri te vlerësimi dhe në certifikimin e kualifikimeve i cili përcillet me punësimin e personit që ka një certifikatë apo diplomë.

<sup>1</sup>Organizata për bashkëpunim ekonomik dhe zhvillim





## VEÇORITË E KUALIFIKIMEVE NË KOSOVË

### TË SHPREHURA SI REZULTATE MËSIMORE

Kualifikimet janë të definuara përmes rezultateve të mësimit të cilat tregojnë se çka parashihet që nxënësi të dijë dhe çka është në gjendje të bëjë pas përfundimit të suksesshëm të modulit apo të programit në tërësi. Në kualifikimet e lidhura me profesione, rezultatet e mësimit fitohen në mënyrë direkte nga kompetencat e identifikuar në standarde profesionale.

#### Shembulli 1

Pas përfundimit të programit nxënësi do të jetë në gjendje të prodhojë dhe kontrollojë dokumentacion relevant që ka të bëjë me shitjet dhe pagesat për prodhime dhe shërbime, verifikon dhe shpjegon dokumentacionin e llogarive të gjeneruar nga sistemi kompjuterik, identifikon situatën e qarkullimit të keshit dhe përgatit llogaritë finale për auditim.

(Kualifikimi Asistent i Administrimit të Biznesit, specializimi Financa).

### BAZUAR NË MODULET MËSIMORE

Sipas Ligjit mbi Kualifikimet Kombëtare, kualifikimet mund të jenë ' të dizajnuara për të lejuar akumulimin dhe transferim të kredive". Kjo mund të arrihet përmes kualifikimeve modulare.

Në të gjitha kualifikimet, modulet mësimore janë të ndërtuara si blloqe të programeve dhe janë vlerësuar dhe njohur si të arritura mësimore në të drejtën e tyre. Sistemi i bazuar në module ofron:

- Fleksibilitet në ofrim – në aspektin kohor, mënyrë dhe vend.
- Mundësi të krijimit të kurseve për të përmbushur nevojat lokale apo individuale apo për rrethana të caktuara .

- Ndërrimeve rapide teknologjike/ apo nevojave industriale.
- Qasje me nxënësin në qendër.

Modulet mësimore mund të jenë obligative dhe opcionale. Një kualifikim është i ndërtuar si kombinim i moduleve obligative dhe atyre opcionale/zgjedhore. Ky kombinim i jep kualifikimit përmbajtje dhe kuptim, reflekton një varg kompetencash për realizimin e profesionit të caktuar.

## Shembulli 2

Modulet obligative për kualifikimin "Asistent i Administrimit të Biznesit" janë:

Ndërmarrësi  
Komunikim biznesi  
Anglishtja për hulumtim  
Aplikim softveri, etj.

Modulet zgjedhore që qojnë në specializim Financa janë:

Raportim financiar  
Sisteme financiare dhe kontabilitet  
Menaxhment financiar  
Menaxhim i kontabilitetit, etj.


Në arsimin dhe aftësimin profesional fillestar në Kosovë, kualifikimet përfshijnë lëndët e përgjithshme arsimore, modulet obligative dhe modulet zgjedhore. Modulet obligative dhe modulet zgjedhore mbulojnë shkathtësitë e përgjithshme, njohuritë dhe shkathtësitë profesionale dhe janë të shprehura në rezultate të mësimi, duke përshkruar atë se çka parashihet që nxënësi të bëjë pas përfundimit të suksesshëm të modulit.

## ARTIKULIMI DHE PROGRESI

Kualifikimi dhe modulet e veçanta mësimore duhet të zhvillohen në hierarki të lëndëve për t'ju lejuar nxënësve të përparojnë brenda Kornizës së Kualifikimeve Kombëtare (sistemit) në nivelin e aftësive të tyre.

Kjo veçori e ndihmon kandidatin të ndërtojë shkathtësitë dhe njohuritë në prapavijën e fazës paraprake si themel për fazën e re.

### Struktura e përgjithshme e kualifikimeve kombëtare në Kosovë



## Teknik i elektronikës konsumuese - Strukturat e kurrikulit

Lëndët e përgjithshme 6 Orë	Aftësimi në punë 6 Orë	Ndërmarrësia 6 Orë		Audio/Video/MM (Moduli 2) 6 Orë	Zbulimi dhe riparimi i TV Marrësit 6 Orë	Modulet e Avancuara
Lëndët e përgjithshme 6 Orë	Aftësimi në punë 6 Orë			Audio/Video/MM (Moduli 1) 6 Orë	TV Marrësit 6 Orë	
Lëndët e përgjithshme 6 Orë				Aplikim softveri (Moduli 6 + 7) 6 Orë	Antenat dhe marrësit e sinjaleve (6 Orë)	Modulet e Mesme
Lëndët e përgjithshme 6 Orë	Gj. angleze teknike (Moduli 2) 6 Orë			Aplikim softveri (Moduli 4 + 5) 6 Orë	Audio/Video/MM (Moduli 1) 6 Orë	
Lëndët e përgjithshme 6 Orë	Gj. angleze teknike (Moduli 1) 6 Orë	Matematika teknike (Moduli 2) 3 Orë	Aplikim softveri (Moduli 2 + 3) 6 Orë	Qarqet e inegruara lineare 6 Orë	Qarqet logjike digjitale 6 Orë	Modulet Themelore
Lëndët e përgjithshme 6 Orë		Matematika teknike (Moduli 1) 3 Orë	Aplikim softveri (Moduli 1) 3 Orë	Bazat e elektronikës 12 Orë	UL dhe matje në elektronikë 6 Orë	

## VLERËSIMI I BAZUAR NË DËSHMI

Vlerësimi për dhënien e kualifikimeve profesionale bëhet kundrejt rezultateve mësimore dhe kritereve të performansës/realizimit. Nxënësi duhet të prodhojë dëshmi të njohurive dhe performansës ashtu siç ato janë përshkruar në modul. Suksesi duhet që të demonstronhet kundrejt të gjitha rezu ltateve mësimore që përkasin modulit të caktuar. Sistemi lejon vlerësim ‘holistik’ të rezultateve mësimore bazuar në një strategji vlerësimi, nëse është planifikuar vlerësimi dhe instrumentet e vlerësimit janë hartuar për të mbuluar një numër të rezultateve mësimore si një aktivitet i tërë.

Modulet vlerësohen në mënyrë të brendshme nga ana e arsimtarëve/ trajnerëve të cilët japin mësim. Vlerësimi ka verifikim të brendshëm ndërmjet arsimtarëve/ trajnerëve dhe nga verifikim të jashtëm nga AKK.

Proceset vlerësimit dhe verifikimit të brendshëm dhe të jashtëm janë të definuar shumë qartë nga AKK e cila është duke e implementuar sistemin e sigurimit të cilësisë për kualifikimet kombëtare . Verifikimi i brendshëm dhe i jashtëm janë pjesë të procesit të sigurimit të cilësisë dhe roli i tyre është që të sigurohemi se vlerësimi është realizuar në mënyrë që është vlefshme, e qëndrueshme dhe e besueshme.

Vlerësimi për certifikim përfshin vlerësimin e jashtëm të moduleve dhe mund të bashkohet me një seri të vlerësimeve të jashtme (nga AKK), të cilat testojnë kapacitetin e nxënësve për të integruar njohuritë, të kuptuarit dhe shkathtësitë e arritura gjatë studimit të një numri të moduleve.

## KUALIFIKIMET DHE MODULET MËSIMORE

Për shkak të rolit të tyre dual (që lejon qasje në punësim dhe në arsim/ aftësim të vazhdueshëm) kualifikimet e dizajnuara për AAP në Kosovë përmban modulet e arsimit të përgjithshëm, modulet e shkathtësive të përgjithshme dhe modulet që lidhen me profile të caktuara profesionale.

Në arsimin dhe aftësimin profesional, kualifikimet janë realizuar në cikle të plota mësimore të cilat zgjasin 2 apo 3 vite. Në mënyrë ideale programet kanë dalje të lirë në përfundim të secilit vit shkollor, ashtu që secili person që ndjek për disa vite procesin mësimor, me kohëzgjatje më të shkurtër se sa kohëzgjatja e plotë e programit, mund të fitojë njohjen për të arriturat e demonstruara.

### Shembulli 4

Pas përfundimit të modulit, nxënësi duhet të jetë në gjendje të dizajnojë dhe krijoj webfaqe për prezantim individual apo biznesi duke përdoruar pakot standarde të dizajnit të webfaqeve.

(Kualifikimi Teknik i Elektronikës Konsumuese, Moduli Aplikim softueri)

<sup>2</sup> Detaje tjera të vlerësimit janë të paraqitura në doracakun ‘Vlerësimi i Kualifikimeve profesionale Modulare’

### **Shembulli 5**

Pas përfundimit të modulit, nxënësi duhet të jetë në gjendje të përgatisë raporte të ndryshme financiare për lloje të ndryshme të organizatave dhe të bëjë gjykime për këto raporte, përfshirë përgatitjen e llogarive grupore në formën përfundimtare.

(Kualifikimi 'Asistent i Administrimit të Biznesit',  
Moduli Raportim financiar)

Modulet janë blloqe të ndërtuara të kualifikimeve. Kualifikimet profesionale përmbajnë module të detyrueshme dhe zgjedhore. Edhe modulet obligative dhe ato zgjedhore duhet të ndërtohen në bazë të standardeve profesionale të zhvilluara nga Industria, prandaj ekspertët në profesionet përkatëse duhet të vendosin në kombinimin e moduleve të nevojshme për të ndërtuar ndonjë kualifikim.

Nuk ka rregull të artë për zgjedhjen e emrit të programit nga seria e standardeve profesionale. Në përgjithësi, funksionet e identifikuara në standardet profesionale qojnë në definimin e rezultateve mësimore dhe më tutje në modulet mësimore, por ky nuk është një opsion i vetëm. Në përgjithësi, me rastin e dizajnit të programeve për zanatli, ato janë shumë qartë të lidhur me profesionin.

Për shembull kualifikimi i 'Muratorit' qon në profesionin murator dhe parashihet të përmbajë modulet të cilat zhvillojnë njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat për personin që do të mund të punësohet si murator, siç janë: ngritja e strukturës së murit, vendosja e strukturave të murit.

Në të njëjtën kohë performansa e mirë kërkon kompetenca me përmbajtje më të përgjithshme siç janë: përdorë dhe zhvendosë resurset, merret me sigurimin e përgjithshëm të vendit të punës, ushtron praktika efikase të vendpunimit.

Të gjitha këto module të mësipërme qojnë në kompetencat minimale të nevojshme për muratorin dhe ato bëhen module obligative.

Përveç këtyre, janë disa funksione të tjera që lidhen me punët e muratorit, siç janë lyerja dhe rrafshimi i sipërfaqeve, ngritjen e mbulesës së murit, mirëmbajtja e murit të tullave. Muratori duhet të jetë në gjendje të kryejë këto detyra, por jo domosdoshmërisht të gjitha këto. Pasi që nxënësi ti realizoj modulet e detyrueshme, ai mund të zgjedhë që të merr vetëm ndonjë nga modulet zgjedhore dhe ende mund të punësohet si murator.

Kushti i tjetër ka të bëjë me numrin e kredive të cilat duhet ti akumuloj nxënësi për tu kualifikuar si punëtor i kualifikuar. Nëse vlen rregulla që për të arritur kualifikimin e muratorit nxënësit i duhet të akumuloj 120 kredi, atij i duhet ti merr të gjitha modulet e detyrueshme për të akumuluar p.sh. 80 kredi, plus modulet zgjedhore që qojnë në akumulimin e 40 kredive të mbetura.

Me rastin e zhvillimit të programeve mësimore për standarde të ndryshme profesionale, zhvilluesit mund të arrijnë në përfundimin që disa module janë të përbashkëta për disa profesione. P.sh. moduli Aplikim është i përshtatshëm si për asistentin e marketingut, asistentin e financave dhe asistentin administrativ. Në këtë situatë moduli përkatës do të përfshihet në tri programet mësimore dhe bëhet pjesë e përbashkët për të tria. Modulet që janë të përbashkëta për disa profesione të ndërlidhura bëhen pjesë e përbashkët e programit, përderisa modulet tjera që qojnë në specializim mund të konsiderohen si opsione për rrugë të ndryshme profesionale. Rregulla bazike mbetet që ekspertët në profesionet përkatëse duhet të përcaktojnë se cilat module janë obligative dhe cilat për dhënien e kualifikimit të plotë, e gjithashtu se cili është kombinimi i moduleve që qojnë në secilin kualifikim.

## KËRKESAT HYRËSE

Artikuli i moduleve dhe programeve kërkon raportin për kërkesat hyrëse si për modulën ashtu edhe për kualifikimin. Kjo gjë nënkupton se për secilin modul dhe program, zhvilluesit duhet të identifikojnë kushtet minimale për një individ të ketë qasje në modulën apo programin përkatës. Nganjëherë, veçanërisht në rastin e trajnimit të vazhdueshëm profesional, qasja në programe është në diskrecion të vet institucionit profesional. Në rast se kualifikimi ofrohet brenda arsimit dhe aftësimin profesional, kushtet për hyrje përfshijnë nevojën e nxënësit për të diplomuar në nivelin e caktuar të arsimit.

### Shembulli 6

Kërkesat hyrëse për modulën Aplikim softueri 1  
Është e nevojshme që të trajnuarit duhet të kenë certifikatën e arsimit të detyrueshëm.

### Shembulli 7

Kërkesat hyrëse për modulën Aplikim softueri 2  
Është e nevojshme që të trajnuarit duhet të kenë certifikatën e arsimit të detyrueshëm dhe njohuritë paraprake dhe shkathtësitë ekuivalente me njohuritë/shkathtësitë e fituara nga rezultatet e mësimit të modulit Aplikim softueri 1.

### Shembulli 8

Kërkesat hyrëse për modulën Qarqet e integruara lineare (Kualifikimi Teknik i Elektronikës Konsumuese)

Është e nevojshme që të trajnuarit duhet të kenë certifikatën e arsimit të detyrueshëm dhe njohuritë paraprake dhe shkathtësitë ekuivalente me njohuritë/shkathtësitë e fituara nga rezultatet e mësimit të modulit Punëtori e elektronikës dhe matjet.

## ARSYESHMËRIA PËR KUALIFIKIMIN

Udhëzimi administrativ të ligjit mbi Kualifikimet Kombëtare (Ligji 03/L-060) kërkon promovimin e kualifikimit deri në gjendjen e arsyeshmërisë së tij, i cili është motivim sintetik dhe përshkrim i saj. Sipas definicioneve të ndryshme, në mënyrë ultimative kualifikimet janë lidhje ndërmjet kërkesave të vendit të punës, të përcaktuara në profilet profesionale dhe/ apo në standardet profesionale dhe në strukturën dhe përmbajtjen e programeve, bazuar në modelet

mësimore, me këtë perspektivë, është e qartë se kualifikimi ka arsyeshmërinë e tij, p.sh.:

- Është e adresuar ndaj grupit të synuar
- Bashkon pakon e njohurive të definuar mirë, shkathtësive dhe kompetencave të shprehura në formë të rezultateve mësimore, të cilat i lejojnë personit qoftë për të ushtruar ndonjë aktivitet profesional apo social, apo që të ketë qasje në arsimin dhe aftësimin e vazhdueshëm.

### **Shembulli 9**

Arsuyeshmëria për kualifikimin Riparimi i karrocerisë së automjetit:

Industria e riparimit të karrocerisë së automjeteve bazohet në teknologjinë dhe metodat e riparimit të karrocerive të automjeteve. Në nivelin e këtij kualifikimi, nga nxënësit kërkohet të realizojnë procese të ndryshme dhe komplekse të proceseve të riparimit për të cilat nevojiten të shfrytëzohen vegla, pajisje dhe procese të sotifikuara. Shumica e automjeteve janë të pajisura kohëve të fundit me pajisje të kontrolluara elektronike dhe sisteme të sigurisë, të cilat janë të ndërlidhura dhe kontrollohen nga pllakat kompjuterike, prandaj kompanitë e sigurimeve kërkojnë nga kjo industri që vetëm njerëzit e shkathtë janë lejuar që të realizojnë punët riparuese në automjete, në garazhet e autorizuara.

Kështu, qëllimi i këtij kualifikimi është: to ofrojnë nxënësve mësim në standarde të kërkuara për të punuar në mënyrë efektive për industrinë e riparimit të karrocerive të automjeteve. Ky kualifikim do t'ju mundësoj nxënësve për tu përballuar me sfidat e industrisë, që ka treguar rritje rapide me futjen e teknologjive dhe metodave të reja në industrinë e riparimit të karrocerive.

Ky kualifikim shërben gjithashtu edhe për zhvillimin e shkathtësive të reja për teknologjinë e re. Krijon një infrastrukturë të njohur të përkrahjes teknologjike dhe mundësive në tregun e punës me rritjen e kërkesave për të njohur shkathtësitë e tyre dhe për të përmbushur sfidat e industrinë e riparimit të karrocerive të automjeteve.

Shkathtësia primare që njihet në këtë kualifikim është aftësia për të aplikuar teorinë relevante, me qëllim që të kryhen riparime strukturore në automjete. Shkathtësitë e punëve me dorë gjithashtu luajnë një rol me rëndësi në këtë

kualifikim, e gjithashtu nxënësit të suksesshëm i duhet të aplikojë punë dore për të përmbushur detyrat e kërkuara.

Pas arritjes së këtij kualifikimi nxënësi duhet të jetë në gjendje të: komunikoj me kolegët dhe konsumatorët, në një kontekst pune në industrinë automobilistike, analizoj problemet dhe ofroj zgjidhje në ndonjë punëtori, koordinoj aktivitetet e punës në kontekstin e automobilave, riparon pllakat e dëmtuara të automjeteve, riparon dëmtimet strukturore në vetura etj.

Zhvillimi i kualifikimeve të përgjithshme gjithashtu duhet të ketë arsyeshmërinë, p.sh.: duhet të përmbushë nevojat për zhvillim profesional, personal apo social të individit dhe t'u ndihmoj atyre që e arrijnë kualifikimin përkatës për tu integruar më mirë në punësim apo në ambientin social.

### **Shembulli 10**

Arsyeshmëria për këtë kualifikim Gjuha frënge si gjuhë e huaj, është që tu ofroj nxënësve mundësinë që të kuptojnë bashkëbisedimin bazik në gjuhën Frënge.

Në këtë pikë, duhet të përfshihen disa informata për grupin e synuar. Pasi që kualifikimi ta bëjë të qartë se cilat janë mundësitë e punësimit apo thjeshtë për aplikimin e njohurive të përvetësuara dhe shkathtësitë në një ambient social apo profesional, në ambientin publik apo privat.

## LIDHJET ME PUNËSIMIN

Kualifikimet profesionale, në veçanti dhe shumë herë ato të përgjithshme, paraqesin nevojat e tregut të punës.

### Shembulli 11

Para disa dekadave përdorimi i robotëve në industrinë automobilistike kanë kërkuar kompetenca të cilat nuk janë kërkuar asnjëherë më parë në programet e arsimit dhe aftësisimit. Për këtë arsye shumë vende kanë zhvilluar kualifikimin e quajtur mekatronikë, i cili kombinon, njohuritë, të kuptuarit dhe shkathtësitë e mekanikës, elektronikës dhe informatikës.

Në mënyrë të ngjashme hapja e industrisë së turizmit në vende ku nuk ka qenë traditë dhe diversifikimi i shërbimeve ka sjellë nevojën për njohjen e gjuhëve të huja, siç janë psh kinezishtja. Kjo situatë mund të qoj gjithashtu në iniciativën për futjen e kualifikimit siç është Kinezishtja si gjuhë e huaj për turizëm.

Për kualifikim profesional që do të validohet nga AKK dhe paraqitet në sistemin e Kualifikimeve Kombëtare, është e nevojshme të lëvizim nga supozimet dhe deklaratimet për dëshmitë që nuk vihen në pyetje, për të cilat është zhvilluar kualifikimi përkatës si rezultat i një nevoje të identifikuar, p.sh.

- Rezultatet e hulumtimit të tregut të punës thekson zhvillimin dhe zgjerimin e një kualifikimi të ri, apo shkathtësive dhe njohurive të reja brenda profesioneve ekzistuese.
- Kërkesat për kualifikime shprehen nga grupet e caktuara, siç janë asocionet e punëdhënësve, asociacionet profesionale, odën ekonomike.
- Rezultatet e konsultimeve me grupet e interesit, siç janë palët me interes në AAP, përfaqësuesit e partnerëve social, përfaqësuesit e shoqërisë civile apo ndonjë entitet që mund të identifikoj dhe shprehë nevojat për njohuri dhe shkathtësi të reja të përmbledhura në kualifikim të ri.



## BASHKËNGJITJA E KREDIVE PËR KUALIFIKIME

Të gjitha kualifikimet dhe modulet e regjistruara në KKK duhet të përmbushin kriteret e përgjithshme për aprovim. Këto përfshijnë:  
Nivelin dhe vlerën e kredive të kualifikimit dhe

komponentëve përbërja e të cilave është identifikuar në mënyrë korrekte.

Udhëzimi administrativ 6.1, Kriteri 6.1.6

## QËLLIMI I SISTEMIT TË KREDIVE NË KOSOVË

Qëllimi i sistemit të kredive është që të mundësoj akumulimin dhe numërimin e rezultateve mësimore të fituara në mënyrë jo formale dhe formale në drejtim të kualifikimeve. Transferi i kredive mundëson transferimin në një kualifikim të ndryshëm apo nën-sistem të mësimit të fituar në një institucion, sektor apo fushë. Një sistem i kredive në Kosovë do të:

- Mundësoj akumulimin dhe numërimin e rezultateve mësimore të fituara në mënyrë jo formale dhe formale në drejtim të kualifikimeve;
- Ndihmoj transferin e mësimit nga një suazë në suazën tjetër për validim dhe pranim;
- Rris mundësitë për nxënësit në qasjen ndaj edukimit dhe programeve të aftësisimit;
- Rris mundësitë për lëvizjen e nxënësit midis konteksteve të ndryshme;
- Bëj avancimin brenda programeve dhe proceseve mësimore më lehte;
- Mënjanoj përsëritjen e panevojshme të mësimit të fituar më herët dhe të sigurojnë mekanizma për njohje të mësimit paraprak.

Sistemi i kredive është i bazuar në veçoritë vijuese të AKK-së:

- Kualifikimet e shprehura si rezultate mësimore dhe të vendosura në një nivel në AKK;
- Modulet si pjesë të kualifikimeve, apo si shpërblime të veçanta, po ashtu të vendosura në një nivel në AKK;
- Pikët e kredive;
- Dizajni i kualifikimeve (përfshirë rregullat se si duhet të kombinohen modulet);
- Autoritetet e nominuara përgjegjëse për vlerësim dhe sigurim cilësie të vlerësimit.

Kredia mund të jepet për arritjet e rezultateve mësimore në kualifikime, apo në pjesë të kualifikimeve (moduleve) (Ligji O3/L-060, Paragrafi 2). Këto udhëzime përshkruajnë se si mund të bashkëngjiten kreditë moduleve dhe kualifikimeve.

Pasi që është më lehtë të parashikohet vlera e kredisë gjatë dizajnit të kualifikimeve dhe moduleve, kur zhvilluesit marrin parasysh rezultatet mësimore, natyrën e vlerësimit të kërkuar etj, rekomandohet që këto udhëzime të jenë në dispozicion gjatë procesit të kualifikimit dhe zhvillimit të modulit.

## BASHKËNGJITJA E KREDIVE NË MODULE

Llogaritja e vlerës së kredisë së një moduli kërkon vlerësim profesional. Është e bazuar në përvijën e dhënies së programeve relevante mësimore, dhe në ekspertizën në fushën e arsimit dhe trajnimit në rishikim e sipër. Prandaj ekipi i personave që bëjnë identifikimin e vlerave të kredive të programeve apo moduleve duhet të përfshijnë njerëz me njohuri në lidhje me zhvillimin e programit apo modulit tek grupet e piketuara të nxënësve (apo moduleve të ngjashme). Ekipi përgjegjës për alokimin e kredive duhet të përfshij personelin me njohuri dhe kuptueshmëri të AKK-së dhe përshkruesit e niveleve, përvijën në zhvillimin e kualifikimeve dhe njësive, dhe në përgatitjet e sigurimit të cilësisë së ofruesit.

**HAPI 1:** Definimi i rezultateve mësimore dhe kritereve vlerësuese që duhet arritur në një modul

Moduli është njësia më e vogël që mund të regjistrohet në KKK dhe për të cilën jepet kredia. Kredia jepet për arritjet e të gjitha rezultateve mësimore në modul. Të gjitha rezultatet duhet të arrihen për tu dhënë kredia. Kreditë nuk mund të jepen për pjesë të modulit. Prandaj hap i parë është që të definohet rezultati mësimor dhe kritereve vlerësuese që duhet arritur në modul. Në mënyrë që të regjistrohet si module bartëse-kredish në KKK, modulet do të duhet të përfshijnë:

- Titullin e Modulit
- Rezultatet mësimore të shoqëruara me performancën (p.sh. kritereve e vlerësimit)
- Strategjia e vlerësimit (kërkesat e evidencës për arritjet e rezultateve mësimore)
- Niveli i modulit në KKK

**HAPI 2:** Dakordimi i nivelit të modulit në KKK

Kur dizajnohet një kualifikim, niveli i kualifikimit do të duhet të dakordohet dhe etapizohet në nivelin e KKK-së. Kualifikimet mund të përfshijnë modulet e nivelit të njëjtë si vetë kualifikimi, modulet e regjistruara në nivele më të ultë dhe ato më të larta se sa kualifikimi.

Gjatë dizajnit të një moduli, niveli i kompleksitetit të mësimit do të informoj në mënyrë të pa evitueshme definimin e rezultateve mësimore dhe kriterjën e vlerësimit. Kur të përpilohet moduli duhet të konfirmohet niveli i rezultateve të modulit. Kjo është bërë duke krahasuar modulën me nivelin e përshkruesve të AKK-së. Të tri komponentët e përshkrimit janë marrë parasysh:

- Njohuritë – praktike dhe teorike
- Shkathtësitë – praktike dhe kognitive
- Përgjegjësi personale

Referencat tjera që mbështesin etapizimin mund të përdoren, siç është krahasimi me kualifikimet tjera të ngjashme në nivelet e njohura të AKK-së. Kur të dakordohet niveli i kualifikimit/modulit, duhet të ofrohet evidenca se si është marr vendimi (shih Nivelin e Rekomandimeve në Shtojcën 1 më poshtë).

**HAPI 3:** Llogaritja e vëllimit të mësimit të nevojshëm për të arritur rezultatet

Vlerat e kredive të dhëna për module janë masa të vëllimit të mësimit të nevojshëm për të arritur një modul. Vëllimi i mësimit matet sa i përket "kohës imagjinare", me fjalë të tjera, kohëzgjatja që do të duhet një nxënës mesatar për të arritur rezultatet specifike mësimore me nivelet e kërkuara nga standardet e vlerësimit. Natyrisht, kohëzgjatja aktuale e kohës së shfrytëzuar nga ana e nxënësve mund të ndryshoj.

"Vëllimi i mësimit" është një llogaritje e kohës mesatare së shfrytëzuar nga nxënësit. Bazohet në përvijën e ekspertëve të ofrimit të aftësisë. Nuk pritët të ketë indikacion të saktë të kohës së shfrytëzuar. Në Kosovë, palët pjesëmarrëse kanë rekomanduar se një kredi duhet të jepet për dhjetë orë të mësimit.

Koha e paraparë e mësimit duhet të përfshij të gjitha format e nevojshme për të arritur rezultatet mësimore. Po ashtu duhet të përfshij kohën e nevojshme për të kompletuar kërkesat e vlerësimit të cilësisë të siguruar. Vëllimi i mësimit përfshin për shembull:

- Klasën formale të bazuar në mësimin e instruktuar apo udhëzuar
- Punën praktike
- Aktivitetet mësimore të vet-drejtuar
- Detyrat e vlerësimit
- Mësimi i bazuar në vend të punës
- Praktika përmes fitimit, përdorimit dhe pastrimit të shkathtësive
- Studimi privat i pritur siç janë detyrat e shtëpisë, revidimet etj.

Llojet e aktiviteteve të mësimit dhe vlerësimit dhe përzjerja e aktiviteteve mund të ndryshojnë varësisht nga module në revidim, dhe lloji i programit të marrë parasysh. Për shembull një kualifikim i zhvilluar në shkollat e APP-së mund të bazohet kryesisht në mësimin e bazuar në klasë shkollore dhe disa lokacione të vendit të punës, një program shkathtësisht në vendin e punës mund të përfshij me shumë vende pune të bazuara në mësim dhe në praktikën e punës.

Përpunimi i planit të vëllimit të mësimit nuk është çështje e një aritmetike të thjeshtë (shtimi i një numri orësh). Kjo kërkon një proces të ekspertëve të lëmisë të cilët pajtohen për një shpërndarje. Kur të merret parasysh se sa kohë do ti duhet një nxënësi mesatar të arrij një numër të rezultateve mësimore, është e nevojshme që të :

- Merret parasysh niveli i rezultateve mësimore siç janë përcaktuar gjatë dizajnit dhe specifikimit;
- Referohet përvoja paraprake e implementimit të programit, apo programeve të ngjashme;
- Krahasohet me programet tjera të dhënjës së kredive:

- Merren parasysh pyetjet vijuese:
- Për çfarë lloj nxënësi është dizajnuar kryesisht kualifikimi?
- Çfarë përvoja paraprake kanë ata?
- Çfarë do të dinë ata dhe të jenë në gjendje të bëjnë tani?
- Çka do të jetë e re dhe do të kërkoj shumë udhëzime apo praktikë?
- Çfarë aktivitete mësimore janë paraparë dhe sa do të zgjasin ato?
- Cilat forma të vlerësimit janë të nevojshme për të arritur një modul?

Vëllimi i mësimit duhet të reflektoj vetëm mësimin e nevojshëm për të arritur rezultatet e nevojshme nga moduli. Njohuritë apo shkathtësitë e nevojshme për nxënësin për të filluar një modul nuk janë marrë parasysh. Prandaj do të jetë e nevojshme që të bëhen disa supozime në lidhje me njohuritë dhe shkathtësitë që nxënësit posedojnë kur të fillojnë modulin. Këto supozime po ashtu do të hulumtohen në dizajnin e kualifikimit dhe proceset e dizajnit të moduleve përmes:

- Kërkesat për hyrje në kualifikim
- Rregullat e kombinuara që përcaktojnë pjesën qendrore dhe alternativat
- Shembujt e zhvillimit të kurrikulit të cilat do të informojnë për mësimin paraprak në lidhje me modulin në pyetje

Manuali i AKK-së momentalisht propozon që modulet duhet të kërkojnë minimum dhjetë orë mësimore në mënyrë që të regjistrohen në KKK. Prandaj nëse llogaritja e orëve mësimore rezultojnë se moduli do të ketë më pak se dhjetë orë për mësim dhe vlerësim atëherë moduli do të duhet të ri dizajnohet.

Kur të dakordohet vlera e kredive të një moduli, duhet të ofrohet evidenca se si është arritur vendimi (shih rekomandimet për kredi në Shtojcën 1 më poshtë).

#### **HAPI 4:** Llogaritja e pikëve të kredisë për një modul

Kur të vlerësohet vëllimi mësimi atëherë bëhet konvertimi në pikë kredish. Në Kosovë, palët pjesëmarrëse kanë propozuar një marrëveshje për pikët e kredive për APP për marrje parasysy nga ana e palëve pjesëmarrëse. Prandaj pikët e kredive janë shpërndarë duke pjesëtuar numrin e përgjithshëm të orëve me dhjetë.

#### **HAPI 5:** Zhvillimi i një shqyrtimi të brendshëm të nivelit dhe pikëve të shpërndara të AKK-së në modul

Niveli dhe pikët e kredive të shpërndara në modul duhet të verifikohen në mënyrë të brendshme.

1. Moduli duhet të krahasohet me modulet e ngjashme në kualifikimet që kanë rezultate dhe arritje të krahasueshme mësimore. Nëse vlerat e kredive për arritje të ngjashme janë shumë të ndryshme atëherë arsyet duhet të hulumtohen dhe planifikimet të rishqyrtohen.
2. Moduli duhet të krahasohet me modulet e ngjashme më kualifikimet tjera që kanë rezultate mësimore dhe arritje të krahasueshme. Nëse vlerat e kredive për arritje të ngjashme janë shumë të ndryshme atëherë arsyet duhen të hulumtohen dhe planifikimet të rishqyrtohen.
3. Module duhet të shqyrtohet nga ekspert të pavarur të cilët nuk kanë qenë pjesë e procesit për të shpërndarë vlerat e kredive. Ky verifikim i brendshëm është një hap i rëndësishëm në sigurimin e cilësisë së brendshme.

#### **HAPI 6 :** Kontrolli i supozimeve në lidhje me vëllimin e mësimi gjatë implementimit

Kur të aprovohet dhe është në përdorim moduli është e rëndësishme të vlerësohet gjatë implementimit. Kjo do të kontrolloj nëse parashikimet e vëllimit të mësimi janë të sakta duke intervistuar mësimdhënësit, trajnerët, vlerësuesit dhe studentët që përdorin atë modul. Bazuar në këtë vlerësim, vlera e kredisë mund të rishqyrtohet gjatë kualifikimit të radhës apo rishqyrtimit të modulit.

#### **HAPI 7:** Ruajtja e të dhënave për procesin e shpërndarjes së kredive

Proceset e shfrytëzuara për shpërndarjen e vlerave të kredive për module dhe kualifikime duhet të jenë në dispozicion për monitorim nga AKK. Format e propozuara në Shtojcën 1 do të mbështesin dokumentimin e evidencës për vendimet e vlerave dhe niveleve të kredive.

## BASHKËNGJITJA E KREDIVE NË TËRË KUALIFIKIMIN

Llogaritja e vlerave të kredive të një kualifikimi kërkon një vlerësim profesional.

Bazohet në përvojën e zhvillimit të programeve mësimore relevante, dhe në ekspertizën në fushën e arsimit dhe aftësimit në shqyrtim e sipër. Prandaj ekipi i personave që identifikon vlerat dhe nivelet e kredive duhet të përfshij persona me përvojë në zhvillimin e kualifikimit (apo kualifikimeve të ngjashme) për grupin e piketuar të nxënësve.

**HAPI 1:** Konfirmimi i nivelit të kualifikimit të KKK-së

Është më së lehti të merret parasysh niveli i mësimi dhe të shpërndahet një kualifikim në një nivel të AKK-së gjatë zhvillimit të tij. Prandaj, niveli i AKK-së mund të shpërndahet gjithashtu pasi që është zhvilluar kualifikimi.

Kur bëhet shpërndarja e një kualifikimi në një nivel të KKK-së duhet marrë parasysh synimi dhe fokusi kryesor i kualifikimit. Për kualifikimet që zgjasin disa vite për tu përfunduar, niveli është shpërndarë sa i përket nivelit final të daljes.

Kualifikimi krahasohet me nivelin e përshkruesve të KKK-së dhe të tre komponentët e përshkruesve janë marrë parasysh:

- Njohuritë – praktike dhe teorike
- Shkathtësitë – praktike dhe kognitive
- Përgjegjësitë personale

Referencat tjera do të ishin gjithashtu të ndihmonin etatizimin, siç është krahasimi me kualifikimet tjera të cilat janë vendosur në nivelin e KKK-së.

Evidenca e përdorur për shpërndarjen e kualifikimeve në një nivel duhet të dokumentohet. Kur të dakordohet niveli i kualifikimit, duhet të ofrohet evidenca se si është marrë vendimi (shih Rekomandimet e nivelit në Shtojcën 1 më poshtë).

**HAPI 2:** Bashkëngjitja e e pikëve të kredisë në një kualifikimi të APP-së

Pikët e kredive mund të shpërndahen në tërë kualifikimin bazuar në ofrimim me kohë të plotë në APP formale në Kosovë, propozimi është që një viti me orar të plotë në APP ti shpërndahen 120 kredi. Prandaj një kualifikimi dy vjeçar studimi me orar të plotë do ti shpërndahen 240 kredi.

Një kualifikimi tre vjeçar studimi me orar të plotë do ti shpërndahen 360 kredi <sup>3</sup>.

Kjo metodë mund të përdoret edhe për kualifikimet të cilat nuk kanë module, apo ku disa apo të gjitha modulet nuk bartin kredi.

Kur kualifikimet me orar të plotë përbehen nga modulet me bartje kredish, numri i përgjithshëm i pikëve të kredive për të gjitha modulet e nevojshme për të arritur kualifikimin është afër 120 kredive në vit. Nëse ka mospërputhje të madhe, vlera e moduleve individuale apo e rregullave të kombinimit të kualifikimit duhet të kontrollohet.

Kur të dakordohet vlera e kredisë së kualifikimit, duhet të ofrohet evidenca se si është marrë vendimi (shih Rekomandimet e kredive në Shtojcën 1 më poshtë).

<sup>3</sup> Shënim ky rekomandim ka të bëjë me sistemi e kredive të APP-së. Palët pjesëmarrëse kanë propozuar që viti në APP duhet ti shpërndahen 120 kredi pasi kjo lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë brenda me orët e punës të rishqyrtuara se 1 kredi 10orë mësimore. Pikët e kredive të APP-së lehtë konvertohen në pikë EECTS duke i pjesëtuar me 2, pasi që një vit me orar të plotë studimi në KE i shpërndahen 60 pikë

**HAPI 3:** Zhvillimi i një shqyrtimi të brendshëm të nivelit dhe pikëve të shpërndara për një kualifikim të AKK-së

Niveli dhe pikët e kredive të shpërndara në kualifikim duhet të verifikohen në mënyrë të brendshme.

1. Kualifikimi duhet të krahasohet me kualifikimet e ngjashme që kanë rezultate dhe arritje të krahasueshme mësimore. Nëse vlerat e kredive për arritje të ngjashme janë shumë të ndryshme atëherë arsyet duhet të hulumtohen dhe planifikimet të rishqyrtohen.

2. Kualifikimet duhet të shqyrtohen nga ekspertë të pavarur të cilët nuk kanë qenë pjesë e procesit për të shpërndarë vlerat e kredive. Ky verifikim i brendshëm është një hap i rëndësishëm në sigurimin e cilësisë së brendshme.

**HAPI 4:** Kontrollimi i supozimeve në lidhje me vëllimin e mësimit gjatë implementimit

Kur të aprovohet dhe është në përdorim moduli është e rëndësishme të vlerësohet gjatë implementimit. Kjo do të kontrolloj nëse parashikimet e vëllimit të mësimit janë të sakta duke intervistuar mësime dhënësit, trajnerët, vlerësuesit dhe studentët që janë duke zhvilluar atë kualifikim. Bazuar në këtë vlerësim, vlera e kredisë mund të ndryshoj gjatë dorëzimit të radhës për aprovim të kualifikimit.

**HAPI 5:** mbajtja e të dhënave mbi procesin e dhënies së kredive

Proceset e përdorura për shpërndarjen e vlerave të kredive për kualifikime duhet të jenë në dispozicion për monitorim nga AKK-ja.

## SHTOJCA 1

# FORMATI PËR DËSHMITË E REKOMANDIMEVE PËR NIVELIN

<b>Kursi/Titulli i modulit</b>		
<b>Karakteristikat e nivelit</b>	<b>Niveli që përshtatet më së miri</b>	<b>Argumentimi</b>
Njohuritë dhe të kuptuarit		
Njohuritë praktike		
Shkathtësitë praktike		
Shkathtësitë kognitive		
Përgjegjësia personale		
<b>Niveli i vlerësuar</b>		
<b>Përmbledhje e arsyeshmërisë për nivelin e rekomanduar</b>		
Ku duhet të jetë niveli i rekomanduar në krahasim me kualifikimet ekzistuese/modulet		
<b>Shënimet mbi qasjen e përdorur</b>		
<b>Kush është konsultuar;</b> pikat e diskutimit; çështjet e ngritura, konsultimet me të tjerët psh. Agjencitë e jashtme etj.		
<b>Paneli për verifikimin e jashtëm/ procesi</b>		
<b>Pajtohem/nuk pajtohem</b>		
<b>Komente</b>		

# FORMATI PËR DËSHMITË PËR KREDITË E REKOMANDUARA PËR MODULET

Titulli i modulit		
Hyrja	Përmbledhje e aktiviteteve	Orët
Ligjërata/seminare/ në përgjithësi mësim teorik		
Lëndët e mësimit teorik profesional		
Puna praktike		
Mësim i pa varur (vetëstudim)		
Vlerësime		



Të tjera		
Totali i orëve		
Vlera e kredive	Pjesëtimi i totalit të orëve me 10	
<p><b>Shënime për qasjen</b></p> <p><b>Kush është konsultuar;</b> pikat e diskutimit; çështjet e ngritura, konsultimet me të tjerët psh. Agjencitë e jashtme etj.</p>		
<p><b>Paneli për verifikimin e jashtëm/ procesi</b></p> <p>Pajtohem/nuk pajtohem</p> <p>Komente</p>		







Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar  
nga Zyra ndërlidhëse e Komisionit Evropian

Implementuar nga:



Për më shumë informata, ju lutem na kontaktoni:

Qendra e Studentëve  
Rr. Agim Ramadani p.n.  
Prishtinë, 10000, Kosovë

+381 (0) 38 212 595

+381 (0) 38 213 433

[www.akk-ks.net](http://www.akk-ks.net)